

Përshëndetje znj. H.,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, përcjellë nëpërmjet emailit nga Ministria e Financave me e-mailin e datës 10.3.2025, në lidhje me një prej pikave të kërkesës suaj e konkretisht *“Të dhënat për rritjet e pagave në administratën publike nga viti 2005 deri në vitin 2025 (specifikisht për secilin vit) dhe raporti i tyre me inflacionin dhe kostot e jetesës”*, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Për një kuptim sa më të qartë të përgjigjes sonë në vijim, vlerësojmë se fillimisht është e nevojshme të sqarojmë disa aspekte të sistemit të pagave në administratën publike.

1- Organet që kanë kompetencë për caktimin e pagave për të punësuarit në institucionet e administratës publike, përcaktohen me ligj dhe aktualisht përcaktohen në ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar. Sipas nenit 6 të këtij ligji, kanë kompetencë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë:

- a) Kuvendi;
- b) Këshilli i Ministrave;
- c) këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- d) organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale;
- e) organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;
- f) organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera, të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit, dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit, organizimit dhe funksionimit të tyre.

Në dispozitat vijuese të ligjit nr. 35/2023, sanksionohen kompetencat konkrete në fushën e pagave të secilit prej organeve të sipërpërmendura. Në varësi të organit kompetent, caktimi i pagave apo çdo ndryshim në sistemin e pagave realizohet përmes akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat, në rastin e ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave, botohen në Fletore Zyrtare e si rrjedhim, janë publike dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare www.qbz.gov.al

2- Institucionet buxhetore të administratës publike dhe skemat e pagave që përdorin, në varësi të mënyrës së organizimit të tyre

Në kuptim të ligjit nr. 35/2023, të ndryshuar, “institucione të administratës publike” janë:

- i) institucionet e administratës shtetërore (ku përfshihen: Kryeministria, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, Forcat e Armatosura, përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe administrata e prefektit);
- ii) institucionet e pavarura;
- iii) njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- iv) njësitë e fondeve speciale, si dhe
- v) ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror.

Në këto institucione nuk aplikohet një sistem i unifikuar i pagave. Për punonjësit e këtyre institucioneve “struktura e pagave” (që nënkupton elementet përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve) është e ndërtuar referuar misionit të institucionit/ve, rëndësisë së tyre në sferën e veprimtarisë administrative dhe mënyrës së organizimit e funksionimit të tyre. Për rrjedhojë, aktualisht kemi disa struktura të pagave, ku elementi/ët e pagës janë përcaktuar si vijon:

- a) Struktura e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë, në bazë të raportit me pagën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- b) Struktura e pagave të nëpunësve civilë, në bazë të klasifikimit të nëpunësve civilë, e ndërkohë e njëjta strukturë page aplikohet edhe për:
 - nëpunësit civilë në organet e njësive të vetëqeverisjes vendore,
 - punonjësit mësimorë dhe jo mësimorë në institucionet e sistemit të arsimit parauniversitar,
 - punonjësit e institucioneve të sistemit shëndetësor.
- c) Struktura e pagave të punonjësve të institucioneve të sigurisë, në bazë të gradave. Kjo strukturë page aplikohet për:
 - ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura,
 - punonjësit me grada të Policisë së Shtetit,
 - punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë,
 - punonjësit me grada të Policisë së Burgjeve, SHISH, AMP etj.
- ç) Struktura e pagave të punonjësve administrativë (mbështetës) në bazë të klasifikimit të tyre në 9 (nëntë) klasa për punonjësit mbështetës të institucioneve qendrore apo në 13 (trembëdhjetë) klasa për punonjësit mbështetës të institucioneve rajonale vendore.

3- Rritjet e pagave për periudhën 2005-2025

Rritjet e pagave të funksionarëve/nëpunësve civilë/nëpunësve/punonjësve realizohen në bazë të politikës së përcaktuar nga qeveria shqiptare, për:

- rritje të përgjithshme,
- rritje për shkak të reformimit të strukturës së pagave,
- rritje për të stimuluar punonjës të sistemeve të ndryshme, sipas prioriteteve të qeverisë,
- indeksim të thjeshtë.

Këto parashikime janë realizuar në vite të ndryshme, gjatë këtij harku kohor 20 vjeçar, ku ka pasur reformim të strukturës së pagave e njëkohësisht edhe rritje të niveleve në përqindje të ndryshme, herë herë janë rritur më shumë pagat për punonjësit mësimorë dhe jo mësimorë në institucionet e sistemit të arsimit parauniversitar, sipas parashikimeve apo punonjësit e institucioneve të sistemit shëndetësor, herë herë janë rritur më shumë pagat për punonjësit me grada ushtarake/policore në institucionet e sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë në vend, apo në ndonjë rast ka pasur edhe rritje të përgjithshme në përqindje të caktuara.

Informacionin e detajuar mbi rritjet e pagave ndër vite mund ta konsultoni në raportet vjetore të Departamentit të Administratës Publike, konkretisht në çështjen “Rritje të pagave”. Raportet e çdo viti,

duke filluar nga viti 2005, janë të publikuara në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike dhe mund t'i aksesoni lehtësisht në adresën www.dap.gov.al, në rubrikën “Dokumenta”.

Ndërkohë, për vitin 2024, për të cilin raporti vjetor është në proces përgatitje dhe si rrjedhim, nuk gjendet i publikuar në faqen tonë zyrtare, ju informojmë sa më poshtë vijon:

Politika e rritjes së pagave e filluar në vitin 2023, vazhdoi edhe gjatë vitit 2024. Si rezultat, paga mesatare në administratën publike arriti në 900 euro që ishte premtimi dhe angazhimi i ndërmarrë. Për të përmbyllur këtë reformë gjatë vitit 2024 u miratuan vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet të cilëve u realizua sa vijon:

- > Për nëpunësit civilë dhe të tjerë të barazuar me ta në pagë (përfitues rreth 14.000 punonjës) në:
 - ✓ pozicione specialist - rritje që varion nga 11% deri në 16%;
 - ✓ pozicione drejtuese të institucioneve rajonale/vendore - rritje në masën 9% – 34%, si pasojë e reformës së riklasifikimit të pozicioneve të punës;
- > Për punonjësit mbështetës - rritje në vlerë në masën 4,000 lekë në muaj deri në 8,000 lekë në muaj (përfitues rreth 5000 punonjës);
- > Për rreth 36 mijë punonjës mësimorë dhe të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar – rritje mesatarisht 23% - 53%
- > Në sistemin shëndetësor - rritje mesatare 25% për mjekët ose rritje në vlerë prej 20.000 lekë në muaj për mjekët e përgjithshëm, si dhe rritje mesatare 32% për infermjerët ose rritje në masën 15.000 lekë në muaj për ta (përfitues rreth 20 mijë punonjës të sistemit shëndetësor). Gjithashtu, në këtë sistem u realizua edhe rritja e pagës për punonjësit e administratës së institucioneve shëndetësore, duke i përafruar ata me nëpunësit e tjerë të administratës publike.
- > Në sistemin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë - rritje e pagës për gradë, që varion nga 7% - 22% (përfitues rreth 6.000 ushtarakë të FARSH). Gjithashtu, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura u miratuan ndryshime të masës së shtesave për natyrë të veçantë pune/shërbimi.
- > Në sistemin e Policisë së Shtetit - rritje nga 13.82% deri në 34.63% (përfitues rreth 11.000 punonjës policie).
- > Në sistemin e Policisë së Burgjeve - rritje e pagës për gradë mesatarisht 15,12% (përfitues rreth 3.500 punonjës policie).
- > Në sistemin e Gardës së Republikës së Shqipërisë - rritje e pagës për gradë, që varion 12.9% deri në 34.63% (përfitues rreth 1.400 punonjës të Gardës).
- > Në sistemin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit - rritje e pagës për gradë, që varion nga 6.5% deri në 30.4% (përfitues rreth 1.200 punonjës).
- > Për punonjësit në pozicionet “shofer autoambulance”, në institucionet e shërbimit spitalor, që sigurojnë shërbimin e transportit në kohë reale, për të gjitha rastet e urgjencave mjekësore, u miratua:
 - (i) ndryshimi i klasës së pagës me të cilën trajtoheshin deri përpara miratimit të këtij vendimi, si dhe;
 - (ii) ndryshimi i masës së shtesës për natyrë të veçantë pune nga 14,000 lekë në muaj, në masën 20,000 lekë në muaj (përfitues rreth 500 punonjës “shofer”).

> Për nëpunësit/funksionarët dhe punonjësit e njësisë të vetëqeverisjes vendore, u miratua reforma tërësore e sistemit të pagave, për të cilët u ndryshua mënyra e llogaritjes së vjetërsisë, duke e njësuar atë me nëpunësit civilë në administratën shtetërore, si dhe për efekt të kufirit maksimal, u barazua paga e tyre me atë të klasës përkatëse korresponduese në administratën shtetërore. Rritjet mesatare për këtë grup janë si vijon:

a) për Bashkinë e Tiranës:

a/1) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 23% deri në 65%;

a/2) për vlerat e kufirit maksimal: (i) nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite nga niveli i përgjegjësit të sektorit deri tek niveli i sekretarit të përgjithshëm - rritje vetëm për efekt të ndryshimit të llogaritjes së vjetërsisë në punë në masën 5,1% deri në 7,4%; (ii) nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite për pozicionet specialist - rritje për efekt të rritjes së pagës së pozicionit dhe për efekt të ndryshimit të llogaritjes së vjetërsisë në punë në masën 15% deri në 16%.

b) për bashkitë me mbi 200 000 banorë:

b/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 70%, ndërsa nënkryetarët në masën 50%;

b/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 18% deri në 55,8%;

b/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 57%, ndërsa nënkryetarët në masën 41%;

b/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 15,6% deri në 60%;

c) për bashkitë me mbi 100 001 – 200 000 banorë:

c/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 58%, ndërsa nënkryetarët në masën 70%;

c/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 18% deri në 103%;

c/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 53%, ndërsa nënkryetarët në masën 41%;

c/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 15,6% deri në 84%;

d) për bashkitë me mbi 50 001 – 100 000 banorë:

d/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 128%, ndërsa nënkryetarët në masën 113%;

d/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 19% deri në 103%;

d/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 79.3%, ndërsa nënkryetarët në masën 64%;

d/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 37,5% deri në 94%;

e) për bashkitë me mbi 20001 - 50000 banorë:

e/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 131%, ndërsa nënkryetarët në masën 141%;

e/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 19% deri në 115%;

e/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 92%, ndërsa nënkryetarët në masën 76%;

e/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 52% deri në 105%;

f) për bashkitë deri në 20 000 banorë:

f/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 185%, ndërsa nënkryetarët në masën 249%;

f/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 20% deri në 123%;

f/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 128%, ndërsa nënkryetarët në masën 95%;

f/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 60% deri në 128%;

g) për keshillat e qarqeve:

g/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët - rritje në masën 86%, ndërsa nënkryetarët në masën 113%;

g/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 18% deri në 84%;

g/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët - rritje në masën 53%, ndërsa nënkryetarët në masën 64%;

g/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite - rritje në masën 15.6% deri në 55%.

gj) administratorët e njësive administrative - rritje të kufirit minimal nga 30% - 33% dhe për kufirin maksimal rritje 29% - 75%.

Për vitin 2025, deri tani, nuk ka patur rritje të pagave në administratën publike.

Sa i takon të dhënave mbi raportin e pagave me inflacionin dhe kostos e jetesës, sqarojmë se kjo kërkesë është jashtë fushës së përgjegjësisë së DAP, që në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ka si detyrë të hartojë dhe bashkëpunojë për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 5, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Departamenti i Administratës Publike